



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore në Prizren / Osnovno Tužilaštvo Prizren / Basic Prosecution in Prizren

AD.nr. 7/24

Prizren, Dt. 01.08.2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e avokat [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR] kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, pranë Departamentit për Krime të Rënda, [REDAKTUAR] në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores nr. 05.2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e avokat [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, pranë Departamentit për Krime të Rënda, [REDAKTUAR] sepse nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

A r s y e t i m

Me date 31.07.2024, kryeprokurori i kësaj prokurorie, si autoritet për të vendosur lidhur me ankesat disiplinore ndaj prokurorëve, ka pranuar një ankesë disiplinore nga avokat [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]), përkatësisht mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] i dyshuar për veprën penale vrasje në tentativë, nga neni 172 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, të KPRK-së, e drejtuar kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren pranë Departamentit për Krime të Rënda, [REDAKTUAR] me pretendimet se në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me datë 04.06.2024, prokurori i rastit në praninë e palëve dhe kryetarit të trupit gjykues, kishte bërë një veprim apo sjellje joprofesionale në dëm të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, ku prokurori kishte qenë i ulur afër të dëmtuarit/viktimës dhe në një moment i afrohet të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe ia ngrenë lartë maicën/trikon nga trupi duke e treguar plagën e tij që e kishte marrë si pasojë e tentim vrasjes nga ana e të akuzuarit dhe iu

kishte drejtuar gjyqtares, citoj: "gjyqtare shiko se çka i ka bërë i akuzuari [REDACTED] dhe çfarë plage i ka shkaktuar", ku ky gjest është i papranueshëm dhe jo etik sipas avokatit, përkatësisht këtu ankuesit.

Po ashtu, ankuesi pretendon se në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 30.07.2024, kur është ishte bërë shpallja e aktgjykimit ndaj të akuzuarit [REDACTED] pas shpalljes së aktgjykimit, nga salla menjëherë ishte larguar trupi gjykues dhe i pandehuri, ndërsa për çudi prokurori kishte qëndruar në sallë me palën e dëmtuar, ku në ato momente babai i të akuzuarit [REDACTED] [REDACTED] gjatë daljes nga salla e gjykatës së bashku me avokatin [REDACTED] ishte shprehur me fjalët në drejtim të të dëmtuarit "ishalla shifemi për të mirë" dhe asgjë tjetër, mirëpo sipas ankuesit prokurori e kishte alarmuar situatën duke e paraqitur në polici, e në fakt sipas ankuesit fjalët nuk kanë qenë kërcënuese dhe pa kurrfarë arsye tani i dyshuari [REDACTED] ishte ndaluar nga ana e prokurorit kujdestar për 48 orë. Këto sjellje të prokurorit të shtetit sipas avokatit janë jo të hijshme dhe jo etike dhe nuk është hera e parë që prokurori ka pasur sjellje të tilla edhe në raport me avokatin në fjalë, në kohën kur avokati kishte ushtruar funksionin e [REDACTED]

Me datë 31.07.2024, kryeprokurori si autoritet kompetent, konform nenit 6, paragrafi 4, te Rregullores (05/2019) për Përgjegjësinë Disiplinore të Prokurorëve ka kërkuar deklarate me shkrim nga prokurori lidhur me pretendimet e palës ankuese. Prokurori në deklaratën e tij i mohon pretendimet e avokatit/ankuesit dhe thekson se nuk është e vërtetë ta ketë bërë një veprim të tillë, përkatësisht t'ia kishte ngritur trikon të dëmtuarit sepse ka qenë faza e shqyrtimit fillestar dhe nuk janë administruar provat dhe nuk ka asnjë provë që e vërteton një veprim të tillë të tij por janë supozime të pavërtetuara nga vet avokati, pasi që klienti i tij e kishte pranuar fajësinë dhe ishte dënuar me burgim. Ndërsa, sa i përket reagimit të tij në shpallje të aktgjykimit, ai shprehet se ky është obligim ligjor i prokurorit të shtetit dhe aty kanë qenë prezentë edhe mediet dhe gazetarët dhe e kanë dëgjuar edhe ata se cilat kanë qenë fjalët e babait të të akuzuarit drejtuar viktimës në sallën e gjyqimit.

Kryeprokurori, vlerëson se në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit i bartë të gjitha kompetencat kushtetuese dhe ligjore që rastin në gjykatë ta përfaqësoj në mënyrën më të mirë të mundshme duke i paraqitur faktet dhe provat në mënyrën sa më profesionale dhe bindëse për trupin gjykues. Pretendimi i avokatit se prokurori i kishte ngritur trikon të dëmtuarit për ti treguar gjyqtarit të çështjes plagët e marra në trup nga veprimi i të akuzuarit nuk vërtetohet në asnjë mënyrë dhe një pretendim i tillë nuk është ngritur aty për aty para gjyqtares, as nga avokati apo palët tjera dhe nuk është konstatuar as në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të ditës konkrete. Sipas ankuesit një veprim i tillë pretendohet se ka ndodhur me datë 04.06.2024, ndërsa ankesa është paraqitur me datë 31.07.2024, vetëm pas shpalljes së aktgjykimit dhe dënimit të të akuzuarit.

Edhe po të ishte ashtu siç pretendon ankuesi, kjo përsëri nuk do të paraqiste ndonjë shkelje etike apo profesionale sepse nuk ka cenuar dinjitetin e të dëmtuarit dhe nuk kemi asnjë ankesë as nga vet i dëmtuari/viktima për veprimet apo sjelljet e prokurorit të shtetit dhe nuk është

reaguar as nga mbrojtësi i të akuzuarit aty për aty dhe nuk kemi konstatim të tillë në procesverbal të shqyrtimit fillestar. Në rastin konkret viktimë është trajtuar me respekt, ndjeshmëri, në mënyrë të përshtatshme, profesionale dhe jo diskriminuese nga prokurori i shtetit. Prezantimi i çështjes në gjykatë quhet edhe "art", sepse aftësitë dhe talenti i prokurorëve për të bindur gjyqtarin, aftësia për të paraqitur faktet në mënyrë logjike e të qartë, pa dëmtuar dinjitetin e palëve në procedurë, si dhe fuqia e argumenteve kanë rol të rëndësishëm në rezultatin përfundimtar. Paraqitja apo prezantimi i prokurorit në shqyrtim gjyqësor do të vlerësohet edhe në kuadër të vlerësimit të performancës së punës së prokurorit dhe në rastin konkret nuk konsumon elemente të ndonjë shkelje disiplinore.

Ndërsa, sa i përket pretendimit se me datë 30.07.2024, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kur është ishte bërë shpallja e aktgjykimit ndaj të akuzuarit [REDAKTUAR] pas shpalljes së aktgjykimit, prokurori kishte lajmëruar policinë lidhur me kërcënimin që i është bërë viktimës nga babai i të akuzuarit, në këtë rast prokurori i shtetit e ka kryer detyrimin e tij ligjor që të ndërmer masa në të gjitha rastet kur vlerëson se dyshohet se është kryer një vepër penale.

Andaj, kryeprokurori si autoritet kompetent, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesave të lartcekura, deklaratës së prokurorit dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar dhe vendosur se ankesa është e pabazuar, sepse në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 06/L – 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi që në bazë të shkresave të lëndës konstatohet se prokurori i rastit i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme ligjore konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të gjitha veprimet e prokurorit kanë qenë profesionale dhe ligjore dhe në kuadër të fushëveprimtarisë funksionale dhe profesionale të prokurorit të shtetit.

Me sa u cek më lart u vendos si në dispozitiv të vendimit.

KRYEPROKURORI

[REDAKTUAR]

[REDAKTUAR]

T'i dorëzohet:

- Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Avokat [REDAKTUAR]
- Arkivë